

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË

NR. 4851 Rep.

NR. 340 Kol.



KONTRATË KONCESIONI

E FORMËS “BOT” (NDËRTIM – OPERIM - TRANSFERIM) PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE “GOMSIQE 1”, “GOMSIQE 2”, “GOMSIQE 3”, “GOMSIQE 3’ “ DHE “GOMSIQE 4”.

Në Tiranë, më datë 10, muaji Shkator, viti 2009 (dy mijë e nëntë), para meje noter, Gentur B. Mela, anëtar i dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë R. Surres P. 148, Sh. 1 H/1 u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që më poshtë do të quhet “**AUTORITET KONTRAKTUES**”, përcaktuar si i tillë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 262, datë 12.03.2009, “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me koncension të hidrocentralit “Gomsiqe 1”, “Gomsiqe 2”, dhe “Gomsiqe 3” “Gomsiqe 3’ ” dhe “Gomsiqe 4”, përfaqësuar nga Titullari, z. Genc RULI i datëlindjes _____, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta nr. _____

DHE

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Roan Company” sh.p.k, “Shansi Invest” sh.p.k, “Archimed International” sh.p.k, “Sigers” sh.p.k dhe “Sina - 98” sh.p.k, që në vijim do të quhet “**KONCESIONARI**”, i formuar sipas marrëveshjes nr.1124 Kol, nr.2285 Rep, datë 05/05/2009 me këto te dhena:

Shoqëria “Roan Company” sh.p.k., e cila figuron e regjistruar si person juridik ne QKR me NIPT K41914802 dhe date 16/06/2004 regjistrimi;

Shoqëria “Shansi Invest” sh.p.k., e cila figuron e regjistruar si person juridik ne QKR me NIPT J61924002T dhe date 15/07/1994 regjistrimi;

Shoqëria “Archimed International” sh.p.k., e cila figuron e regjistruar si person juridik ne QKR me NIPT J71931003R dhe date 30/10/1996 regjistrimi;

Shoqëria “Sigers” sh.p.k., e cila figuron e regjistruar si person juridik ne QKR me NIPT J91802011A dhe date 02/12/1994 regjistrimi;

Faqe 1 nga 23

Shoqëria "Sina - 98" sh.p.k., e cila figuron e regjistruar si person juridik ne QKR me NIPT K01321001T dhe date 08/01/2000 regjistrimi;

Shoqëria "Roen Company" sh.p.k. është përcaktuar si shoqëri kryesuese, me prokuren e posaçme nr.1125 Kol, nr.2286 Rep, datë 05/05/2009, dhe përfaqësohet nga administratori Zj.Brunilda Jegeni, e datëlindjes _____ madhore dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u sigurova nga Pasaporta nr. _____

Hyrje

Duke patur parasysh se:

Qeveria e Shqipërisë:

1. I ka dhënë një rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të rinj ose rehabilitimit të hidrocentraleve ekzistues me anë të procedurave të koncesionit, për përmirësimin e treguesve teknikë dhe ekonomikë të rrjetit elektrik kombëtar;
2. Konsideron ndërtimin e hidrocentraleve si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë.
3. Vlerëson formën "BOT" të koncesionit, si një formë koncesioni që bën të mundur nxitjen e investitorëve privatë për ndërtimin e hidrocentraleve të rinj me anën e kapitalit privat;
4. Është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike brenda vendit;
5. Mirëpret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike.

Koncesionari:

1. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor, për ndërtimin dhe operimin e hidrocentraleve të sipërpërmendur, si një propozim i pakërkuar, dhe në përfundim të procedurës përzgjedhëse konkurruese është vlerësuar si ofertuesi më i mirë.
2. Është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentraleve përkatës në rrjedhen e lumit Gomsiqe, rrethi Puke, me qëllim prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë të furnizimit me energji elektrike të zonës;
3. Zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiarë, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektit të kësaj marrëveshje;

4. Zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Palët lidhin këtë kontratë koncesioni bazuar në Ligjin nr.9663 dt.18.12.2006 "Për koncesionet" i ndryshuar, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 262, datë 12.03.2009, "Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të hidrocentraleve "Gomsiqe 1", "Gomsiqe 2", "Gomsiqe 3" "Gomsiqe 3' " dhe "Gomsiqe 4" dhe bien dakord për sa më poshtë:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizime dhe interpretime

1. Kudo që në këtë Kontratë përdoren termat e mëposhtëme, ato do të kenë kuptimet përkatëse si vijon:
 - 1.1. **Kontrata e Koncesionit** : Kjo kontratë, anekset dhe çdo dokument tjetër që do të bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.
 - 1.2. **Ligji "Për Koncesionet"**: Ligji nr.9663, datë 18.12.2006 "Per koncesionet", i ndryshuar.
 - 1.3. **Autoriteti Kontraktues**: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
 - 1.4. **Koncesionari**: Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Roën Company " sh.p.k, "Shansi Invest" sh.p.k, "Archimed International" sh.p.k, "Sigers" sh.p.k dhe "Sina - 98" sh.p.k, me seli ne qytetin e _____, adresa: _____
 - 1.5. **Hidrocentralet**: Hidrocentralet "Gomsiqe 1", "Gomsiqe 2", "Gomsiqe 3" "Gomsiqe 3' " dhe "Gomsiqe 4". me vendndodhje në rrjedhen e lumit Gomsiqe, rrethi Puke, me fuqi të instaluar 20,475 (njetzetmije katerqindeshtatedhjetepese) kW dhe prodhim të energjisë elektrike 101,500,000 (njetqindnjemilion peseqindemije) kWh, i përbërë nga tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike duke përfshirë por pa u kufizuar në to: veprën e marrjes, kanalin e devijimit, bazenin e presionit, tubacionin që dërgon ujin në turbina, lidhjen me sistemin, ndërtesën e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e intaluara në të.
 - 1.6. **Objekti**: Financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajta e hidrocentraleve dhe transferimi i tyre nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
 - 1.7. **Investimi**: Vlera totale në lekë që do të shërbejë për ndërtimin dhe paisjen me makineritë e nevojshme të hidrocentraleve, deri në fillimin e prodhimit të energjisë elektrike.
 - 1.8. **Punimet**: Tërësia e veprimeve për projektimin inxhinierik, ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentraleve "Gomsiqe 1", "Gomsiqe 2", "Gomsiqe 3" "Gomsiqe 3' " dhe "Gomsiqe 4" në përputhje me projektin e zbatimit.
 - 1.9. **Fillimi i punimeve**: Zbatimi i projektit pas miratimit të tij sipas nenit 8.2 të kësaj kontrate.
 - 1.10. **Vënia në punë e hidrocentraleve**: Fillimi i prodhimit të energjisë elektrike pas testimit sipas nenit 11 të kësaj kontrate.

Faqe 3 nga 23

- 1.11. **Kontratat:** Të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari, me sipërmarrësit për realizimin e punimeve ose çdo marrëveshje tjetër e lidhur me të tretët që ka si objekt operimin e hidrocentraleve dhe/ose sigurimin e fondeve financiare.
- 1.12. **Leje dhe Liçenca:** Akte administrative, që lëshohen nga autoritetet përkatës publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate, bazuar në legjislacionin në fuqi.
- 1.13. **Operimi:** Të gjitha veprimet e koncesionarit për prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.
- 1.14. **Tarifa koncesionare:** Sasia vjetore e energjisë elektrike e shprehur në përqindje, që i jepet pa pagesë Autoritetit Kontraktues.
- 1.15. **Llogaritja e afateve:** Kur afati është caktuar me ditë, përjashtohet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.
- 1.16. **Data Efektive:** Nënkupton datën në të cilën kjo Kontratë nënshkruhet nga palët.
- 1.17. **Subjekti i furnizimit me energji elektrike:** Personi i liçencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislacionit shqiptar.
- 1.18. **Sigurimi i kontratës:** Vlera monetare e ngurtësuar në një llogari të posaçme ose në një shoqëri sigurimesh, me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e shkeljes së kontratës nga Koncesionari, sipas Nenit 14.
- 1.19. **Ligj:** Nënkupton çdo ligj organik, dekret, vendim të Këshillit të Ministrave ose çdo ligj tjetër që shpallet si i tillë, rregullore, udhëzim, urdhër, licensë, leje, autorizim ose çdo akt tjetër ligjor i shpallur nga Republika e Shqipërisë, vendime gjyqësore që kanë karakter unifikues, akte zyrtare të lëshuara nga çdo organ qendror dhe/ose vendor, ashtu siç mund të ndryshojnë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.
- 1.20. **Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE):** Është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike që vepron sipas Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, i ndryshuar.
- 1.21. **Aneks:** Çdo deklaratë, vërtetim, autorizim, vendim, urdhër ose dokument tjetër i nënshkruar nga palët që i bashkëlidhet kësaj Kontrate, si pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj, tani apo në të ardhmen.
- 1.22. **Instrument Financiar:** Nënkupton çdo marrëveshje huaje, kredie, marrëveshje siguruese ose çdo instrument tjetër i përdorur nga Koncesionari në lidhje me financimin e objektit të këtij koncesioni, duke përfshirë çdo ndryshim, shtesë, rinovim apo zëvendësim të secilit prej këtyre instrumenteve.
- 1.23. **Pala Financuese:** Nënkupton institucionet financiare të liçencuara si të tilla, që do të ndihmojë Koncesionarin në financimin e objektit të koncesionit.

- 1.24. **“E Drejta për Kalim”** do të thotë e drejta për të kaluar mbi dhe nën Shesh, dhe në çdo pjese të tij, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në të, pa ndërhyrje të parregullt nga ndonjë palë e tretë me qëllimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.
- 1.25. **“Shesh”** do të thotë sheshi që gjendet në rrjedhen e lumit Gomsiqe, në përputhje me termat e referencës të përcaktuara në Dokumentat Standarde.
- 1.26. **“Gëzim i qetë”** do të thotë e drejta ekskluzive për të zënë, përdorur dhe gëzuar Sheshin (duke përfshirë Objektet Ekzistuese) dhe të Drejtën për Kalim gjatë Afatit, në përputhje me këtë Marrëveshje, pa ndërhyrje të parregullt nga Autoriteti Kontraktues ose nga ndonjë Entitet Shtetëror.
2. Përveçse kur përmbajtja parashikon ndryshe, në këtë Kontratë:
 - 2.1. Njëjësi e përfshin shumësin dhe anasjelltas;
 - 2.2. Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjane;
 - 2.3. Çdo frazë që fillon me fjalët "duke përfshirë", "përfshin", "në veçanti", "për shembull", "të tilla si apo të ngjashme, do të kuptohet si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura;
 - 2.4. Titujt e përdorur për nenet, paragrafet, nënparagrafet, Anekset dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate;
 - 2.5. Referimet në dispozitat dhe Anekset janë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat dhe anekset e kësaj Kontrate.
 - 2.6. Pa paragjykim ndaj paragrafit të mësipërm, nëse ka ndonjë konflikt apo mospërputhje ndërmjet dispozitave dhe Anekseve dhe/ose ndonjë shtojcë të Anekseve dhe/ose çdo dokumenti tjetër që i referohemi në këtë Kontratë, konflikti apo mospërputhja do të zgjidhet sipas rendit të mëposhtëm të përparësisë:
 - 2.6.1. Kërkesat e Autoritetit Kontraktues në procedurën konkurruese;
 - 2.6.2. Oferta e Koncesionarit;
 - 2.6.3. Dispozitat e kësaj kontrate;
 - 2.6.4. Çdo Aneks tjetër dhe shtojcat e tyre;
 - 2.6.5. Çdo dokument tjetër që i referohemi në këtë Kontrate ose çdo dokument tjetër bashkëlidhur kësaj Kontrate.

Neni 2

Objekti i Koncesionit

Me anë të kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në bazë të ligjit “Për koncesionet”, i jep Koncesionarit me koncesion të formës BOT (që do të thotë ndërtim, operim dhe transferim i së drejtës së pronësisë dhe operimit, në përfundim të kontratës së koncesionit):

Financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajten e hidrocentraleve Gomsiqe 1”, “Gomsiqe 2”, “Gomsiqe 3”, “Gomsiqe 3” ” dhe “Gomsiqe 4” dhe transferimin e tyre në

Faqe 5 nga 23

përfundim të kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Neni 3 Karakteristikat e hidrocentraleve

3.1. Hidrocentralet “Gomsiqe 1”, “Gomsiqe 2”, “Gomsiqe 3”, “Gomsiqe 3’ ” dhe “Gomsiqe 4”, do të ndërtohen në rrjedhen e lumit Gomsiqe, rrethi Puke, me këto karakteristika:

- **Hidrocentrali “ 1 ”**

- Kuotat e veprave
 - o Kuota e veprës së marrjes ne lumin Gomsiqe 500 m
 - o Kuota e veprës së marrjes ne perroin e Bjeshkes 500 m
 - o Kuota e godinës së centralit ne lumin Gomsiqe 414 m
- Fuqia e Instaluar 2,700 kW
- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike 13,500,000 kWh

- **Hidrocentrali “ 2 ”**

- Kuotat e veprave
 - o Kuota e veprës së marrjes ne lumin Gomsiqe 415 m
 - o Kuota e veprës së marrjes ne perroin qe kalon ne fshatin Qerret i vogel 415 m
 - o Kuota e godinës së centralit ne lumin Gomsiqe 316 m
- Fuqia e Instaluar 3,165 kW
- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike 14,500,000 kWh

- **Hidrocentrali “ 3 ”**

- Kuotat e veprave
 - o Kuota e veprës së marrjes ne perroin Gomsiqe Vogel 450 m
 - o Kuota e veprës së marrjes ne perroin e Bushit 450 m
 - o Kuota e godinës së centralit 300 m
- Fuqia e Instaluar 1,160 kW
- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike 5,500,000 kWh

- **Hidrocentrali “3”**

- Kuotat e veprave

o Kuota e veprës së marrjes ne lumin Gomsiqe	312 m
o Kuota e veprës së marrjes ne perroin Gomsiqe Vogel	318 m
o Kuota e veprës së marrjes ne perroin e Bushit	315 m
o Kuota e godinës së centralit	182 m
▪ Fuqia e Instaluar	6,800 kW
▪ Prodhimi vjetor i energjisë elektrike	34,600,000 kWh

- **Hidrocentrali "4"**

▪ Kuotat e veprave	
o Kuota e veprës së marrjes ne lumin Gomsiqe	180 m
o Kuota e veprës së marrjes ne perroin e Bushit	180 m
o Kuota e veprës së marrjes	70 m
o Kuota e godinës së centralit	182 m
▪ Fuqia e Instaluar	6,650 kW
▪ Prodhimi vjetor i energjisë elektrike	33,400,000 kWh

Neni 4
Periudha e Koncesionit

4.1. Koncesioni jepet për një periudhë prej 35 (tridhjetepesë) vjetësh nga Data Efektive dhe përfundon në ditën e përvjetorit të 35-të të Datës Efektive ("Periudha Efektive"). Megjithatë, në rastin e Zgjidhjes përpara afatit 35 vjeçar, Periudha e Koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet tek periudha që fillon nga Data Efektive dhe mbaron në Datën e Zgjidhjes.

4.2. Rastet e zgjatjes së Periudhës së Koncesionit:

4.2.1. Palët bien dakord se për shkaqe që ndikojnë drejtpërdrejt në Projekt (jo të shkaktuara nga Koncesionari) ku përfshihet vetëm Forca Madhore periudha e koncesionit do të zgjatet, në përputhje me kohën e duhur që projekti të konsiderohet si rentabël dhe financiarisht i përshtatshëm në përputhje me analizat financiare të "Vlerës për Para", "IRR" apo çdo lloj analize tjetër të përshtatshme për vlerësime të tilla.

4.2.2. Palët bien dakord se Periudha e Koncesionit do të zgjatet në rastin e një Ngjarjeje të Forcës Madhore, për një periudhë kohe të barabartë me kohën që ka zgjatur Ngjarja dhe kohën e arsyeshme që nevojitet për riparimin e dëmeve të shkaktuara, me kusht që vetë Ngjarja të ketë zgjatur një periudhë kohe që e kalon 1 (një) muaj.

KREU II
TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Faqe 7 nga 23

Neni 5 Të drejtat koncesionare - Sheshi

5.1. Dhënia e të Drejtave Koncesionare

Që në Datën e Hyrjes në Fuqi, Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit, i cili i pranon të drejtat ekskluzive për të gjithë Afatin:

- i. të projektojë, financojë, ndërtojë, testojë, të ketë në pronësi, të operojë dhe të mirëmbajë Hidrocentralin;
- ii. t'i zgjerojë e shtojë Objektet Ekzistuese, nese ka, të ketë në pronësi pjesët e Objekteve Ekzistuese të zgjeruara a të shtuara, kur është e mundur të bëjë veçimin e këtyre pjesëve në përputhje me Ligjin, dhe të shfrytëzojë dhe mirëmbajë Objektet Ekzistuese.
- iii. në varësi të Nenit 5.2 më poshtë, të ketë Gëzim të Qetë;
- iv. me mbarimin e Afatit t'i kthejë sërish Autoritetit Kontraktues përdorimin e Sheshit dhe të Drejtën për Kalim, dhe t'i transferojë Autoritetit pronësinë e Hidrocentralit dhe të Objekteve Ekzistuese të shtuara, nese ka; si dhe, në çdo rast, t'i kryejë ato veprime, të cilat janë pazgjidhmërisht të lidhura me këto aktivitete (së bashku, "**të Drejtat Koncesionare**").
- v. Koncesionari do të ketë të drejtën ekskluzive ndaj çdo atributi mjedisor që mund të gjenerohet nga Projekti, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në certifikatat CER,

5.2. Dhënia e Sheshit

Pavarësisht nga sa parashikohet në Nenin 5.1 më sipër, Sheshi, e Drejta për Kalim, Gëzimi i Qetë do të konsiderohen se i jepen koncesionarit vetëm pasi Koncesionari të pajisë Autoritetin Kontraktues me kopje autentike të certifikatave siguroese që vërtetojnë (në një masë të arsyeshme të kënaqshme për Autoritetin Kontraktues), se Koncesionari është pajisur me policat e sigurimit dhe garancitë e kërkuara për këtë qëllim në përputhje me nenin 15 të kësaj kontrate.

Në lidhje me dhënien e Sheshit, të Drejtës për Kalim, Gëzimit të Qetë dhe të drejtës për akses dhe për të përdorur ujin e lumit Gomsiqe, Koncesionari e pranon Sheshin "siç është" që nga data e një dhënieje të tillë, si dhe Autoriteti Kontraktues nuk do të kryejë ndonjë shpenzim, as nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë Pretendim përkundrejt Koncesionarit, në lidhje me gjendjen e Sheshit.

Neni 6 Monitorimi dhe Mbikqyrja e Përgjithshme

6.1. Monitorimi

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë që në periudha kohore prej 3 muajsh, gjatë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të monitorojë objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues mund të ushtrojë këtë monitorim në çdo kohë në rast se ka informacione të arsyeshme dhe të besueshme në lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve të kësaj Kontrate.

6.2. Mbikqyrja e përgjithshme e punimeve

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të ushtrojë mbikqyrje të përgjithshme me afate tre mujore, gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit.

Në rast të shkeljeve të Kontratës, të konstatuara gjatë monitorimit dhe mbikqyrjes së përgjithshme, Koncesionari do të njoftohet me shkrim për masat që do të merren dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

Neni 7 Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

- 7.1. Të sigurojë vazhdimësinë e kësaj kontrate pavarësisht ndryshimeve të objektivave të Sektorit Elektroenergjetik Shqiptar.
- 7.2. Autoriteti Kontraktues me kërkesë të Koncesionarit merr përsipër të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar këtë të fundit tek organet shtetërore për çdo pengesë që mund të haset në kuadër të pajisjes me leje, licenca, autorizime apo çdo lloj tjetër leje që nevojitet për ekzekutimin e punimeve dhe operimin e kësaj vepre. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm kur mospajisja me leje, licensë, autorizim, etj, vjen si rezultat i mospërbushjes së kërkesave ligjore përkatëse për shkak të Koncesionarit.
- 7.3. Nëse kerkohet nga koncesionari, Autoriteti Kontraktues do të miratojë shpronësimin e pasurisë së paluajtshme private të nevojshme për ndërtimin e hidrocentralit. Kosto e këtij shpronësimi do të mbulohet nga koncesionari dhe procedurat që do të aplikohen janë ato të percaktuara në legjislacionin në fuqi për shpronësimet në kohën e realizimit të procedurës së shpronësimit. Nëse pasuria është publike në pronësi të pushtetit vendor, procedurat do të zhvillohen në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 7.4. Të miratojë projektin e Zbatimit të hidrocentraleve, të përgatitur nga vetë Koncesionari, në përputhje me propozimin për të cilin është shpallur fitues në procedurën e garës.
- 7.5. Të ndihmojë Koncesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike për qëllime të realizimit të objektivit të kësaj kontrate.

- 7.6. Të garantojë, nëse kërkohet nga Koncesionari, detyrimin e subjektit të furnizimit të energjisë elektrike për të blerë energjinë elektrike të prodhuar nga këto hidrocentrale, përmes një kontrate afatgjatë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 7.7. Të garantojë Koncesionarin që ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike nuk do të ndikojë në mbarëvajtjen e projektit të Koncesionarit.
- 7.8. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për detyrimet ligjore dhe kontraktore në rast të mospërmbushjes së këtyre detyrimeve nga ana e tij duke shpërblyer të gjitha dëmet e shkaktuara Koncesionarit për shkak të shkeljes së Kushteve të përcaktuara në kontratën e koncesionit.

KREU III TE DREJTAT DHE DETYRIMET E KONCESIONARIT

Neni 8 Detyrimet e Koncesionarit

- 8.1. Koncesionari është i detyruar të zbatojë Projektin dhe objektin e Kontratës konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Koncesionari duhet që:

Të themelojë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit, shoqërinë koncesionare, që do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri.

Me krijimin e shoqërisë së re koncesionare, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me këtë kontratë do të transferohen nga Koncesionari tek Shoqëria Koncesionare duke filluar që nga data e regjistrimit të Shoqërisë Koncesionare në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Koncesionari dhe shoqëria e re e krijuar do të jenë solidarisht përgjegjës për të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë kontratë.

Një kopje e aktit të themelimit, statutit dhe regjistrimit të shoqërisë së re si person juridik, do të dorëzohet Autoritetit Kontraktues brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit, për të marrë miratimin e këtij të fundit, duke patur parasysh që miratimi i këtij të fundit të jepet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentit përkatës. Në rast vonese për shprehjen e miratimit, konsiderohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka vërejtje apo sugjerime në lidhje me themelimin e personit të ri juridik. Në mënyrë të veçantë kërkohet që në përmbajtjen e Statutit të përfshihen të paktën:

- i. Forma e shoqërisë: Forma e shoqërisë do të jetë "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose "shoqëri aksionere", duke funksionuar në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

Faqe 10 nga 23

- ii. Objekti i shoqërisë: Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve “Gomsiqe 1”, “Gomsiqe 2”, “Gomsiqe 3”, “Gomsiqe 3’ ” dhe “Gomsiqe 4”, tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike, në zbatim të kësaj Kontrate Koncesioni. (Nuk lejohet asnjë lloj tjetër veprimtarie tregtare përveç atyre që ushtrohen në kuadër të kësaj Kontrate);
 - iii. Kohëzgjatja: Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me afatin e kësaj Kontrate Koncesioni;
 - iv. Themeluesi i shoqërisë: Shoqëria e re do të themelohet vetem nga Koncesionari.
- 8.2. Të marrë të gjitha lejet dhe licensat e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 8.3. Të zbatojë preventivin e paraqitur sipas Aneksit 1 bashkëlidhur kontratës;
- 8.4. Të marrë masa që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuar dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë;
- 8.5. Të zbatojë projektin për ndërtimin e hidrocentraleve Gomsiqe 1”, “Gomsiqe 2”, “Gomsiqe 3” “Gomsiqe 3’ ” dhe “Gomsiqe 4”, me fuqi totale të vendosur jo më pak se 20,475 kW;
- 8.6. Të administrojë projektin për periudhën e koncesionit;
- 8.7. Të kërkojë nëse e gjykon me interes dhe të përshtatshme, zbatimin e detyrimit të Autoritetit Kontraktues sipas pikës 5 të nenit 7, më sipër.
- 8.8. Të parandalojë dhe kontrollojë çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga ndonjë punim i tij dhe të kthejë ambientin, me shpenzimet e veta, në situatën e mëparshme (para ndotjes).
- 8.9. Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t’i shkaktohen Autoritetit Kontraktues apo palëve të treta.
- 8.10. Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;
- 8.11. Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.
- 8.12. Koncesionari nuk duhet të ndërhyjë në burimet ujore që furnizojnë ujësjellësin e zonës;
- 8.13. Koncesionari duhet të marrë masa për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit në fuqi për ruajtjen e ekosistemit natyror, si dhe të sasisë së ujit ekologjik në shtratin parësor të burimit ujor (lumit/përroit) në përputhje me rregullat ligjore në fuqi;
- 8.14. Koncesionari duhet të sigurojë ujin e nevojshëm për vaditje, në përputhje me nevojat e bujqësisë dhe legjislacionin në fuqi për rezervat ujore.
- 8.15. Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;
- 8.16. Koncesionari ka të drejtë, kundrejt zgjedhjes së tij për shitjen e energjisë që i përket pjesës së tij të energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet, po ashtu me qëllim marrjen e

çertifikatave të gjelbërta apo ndonjë nxitje tjetër ekuivalente, që ka të bëjë me prodhimet e energjive të rinovueshme, duke patur parasysh parashikimin e pikës 8 të këtij neni.

- 8.17. Në kuadër të zbatimit të punimeve për realizimin e projektit, bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.2.2001, "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", Koncesionari është i detyruar të emërojë një subjekt në rolin e mbikqyrësit të punimeve. Ai mund të jetë person fizik, juridik, vendas apo i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për ushtrimin e kesaj veprimtarie.
- 8.18. Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noteriale.

Neni 9 **Vlerësimi i Investimeve**

- 9.1. Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 2,149,411,466 (dymiliarde njëqindedyzetentemilion katerqindenjembdhjetemije katerqindegjashtedhjetegjashte) lekë, sipas Aneksit nr. 1 bashkëlidhur, nga të cilat 533,250,900 (peseqindetridhjetetre milion, dyqindepesedhjetemije e nentëqind lekë do të investohen në makineri e pajisje.
- 9.2. Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve:
- pas variantit përfundimtar të projektzbatimit;
 - në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës;
- 9.3. Vlera totale e investimit mund të jetë më e madhe se 2,149,411,466 (dymiliarde njëqindedyzetentemilion katerqindenjembdhjetemije katerqindegjashtedhjetegjashte) lekë, por jo më e vogël se një ndryshim të investimit në vlerën 5% (pesë përqind) të investimit total të parashikuar.

Neni 10 **Programi punimeve**

Koncesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të punimeve :

- 10.1. Koncesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 90 ditësh nga data e lëshimit të lejes së ndërtimit.
- 10.2. Koncesionari merr përsipër të verë në punë veprën hidroenergjetike brenda 26 (njetegjashte) muajve nga data e lëshimit të lejes së ndërtimit, sipas grafikut të punimeve të paraqitur në Aneksin 2, bashkëlidhur.
- 10.3. Këto afate do të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre.
- 10.4. Koha e shtyrjes do të jetë sa koha e vonesave të krijuara nga subjektet shtetërore.

Faqe 12 nga 23

Neni 11 Testimi i veprës

- 11.1. Në përfundim të punimeve, duhet të kryhet testimi i veprës, për të siguruar funksionimin e hidrocentraleve. Testimi do të fillojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të bërë nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
- 11.2. Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe të Koncesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë të hidrocentralit, brenda 60 ditëve nga fillimi i testimit, duke patur parasysh kompleksitetin e veprës.
- 11.3. Në rast mospjesëmarrjeje të Autoritetit Kontraktues gjatë testimit, Koncesionari ka të drejtë të kryejë vetë testimin dhe vënien në punë të veprës, duke njoftuar Autoritetin me shkrim, brenda 30 ditëve nga testimi dhe vënia në punë.

Neni 12 Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit

12.1. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka te drejte te zgjidhe kontraten:

- 12.1.1. Kur Koncesionari nuk fillon punën për 6 muaj (për shkak të tij) nga data e marrjes së lejes së ndërtimit sipas nenit 10.1. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14.
- 12.1.2. Në rast të mosrealizimit të fuqisë së vendosur në masën 10 %, kundrejt projektit të propozuar nga Koncesionari;
- 12.1.3. Kur Koncesionari braktis punimet e zbatimit për më shumë se 100 (njëqind) ditë të njëpasnjëshme. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14 si dhe hidrocentralin siç është në momentin e braktisjes, pa patur asnjë detyrim të çdo lloji karshi koncesionarit apo shoqërisë koncesionare.
- 12.1.4. Kur shoqëria e re koncesionare është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi, për faj të koncesionarit. Nëse është e aplikueshme, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14.
- 12.1.5. Kur Koncesionari nuk zbaton në mënyrë të përsëritur një/disa nga detyrimet e tij të parashikuara në këtë Kontratë.

Zgjidhja e njëanshme e kontratës nuk çliron Koncesionarin nga detyrimi për të vazhduar zbatimin detyrimeve që kanë të bëjnë me dorëzimin e hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues. Palët bien dakord që dorëzimi do të bëhet brenda një afati kohor prej 60 ditësh, duke filluar nga momenti i zgjidhjes.

Nëse ky detyrim nuk përmbushet nga Koncesionari atëherë, Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e hidrocentraleve, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë.

12.2. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Koncesionari:

Koncesionari, ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë kur Autoriteti Kontraktues është në shkelje serioze të detyrimeve të tij kontraktore dhe nuk e korrigjon këtë shkelje, brenda afatit të përcaktuar në pikën 12.4 të këtij neni.

12.3. Zgjidhja e kontratës nga secila palë:

Secila nga palët ka të drejtë të zgjidhë kontratën kur:

12.3.1. Megjithë plotësimin e kritereve për aplikim për leje, liçenca ne perputhje me legjislacionin ne fuqi nga ana e Koncesionarit dhe ndërhyrjen e Autoritetit Kontraktues, nuk është pajisur me to, për fillimin e punimeve dhe/ose operimin e Projektit.

12.3.2. Në rastet e parashikuara nga neni 20 pika 20.3 e kësaj kontrate

12.4. Njoftimi i zgjidhjes së kontratës

Secila nga Palët që kërkon zgjidhjen e kësaj Kontrate në përputhje me këtë nen, do të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën tjetër. Njoftimi duhet të përmbajë:

- i. Detajet e duhura duke nënvizuar shkakun e zgjidhjes;
- ii. Datën e përfundimit të kontratës, në rast të moskorrigjimit të shkeljes brenda 30 ditëve nga data e njoftimit;
- iii. Hollësitë e llogaritjes së pagesave si rezultat i zgjidhjes së kontratës;
- iv. Çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

12.5. Zgjidhja e kontratës me konsensus:

Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm, duke negociuar mënyrën e kompensimit të investimit. Gjithësesi, Koncesionari ka të drejtë të kërkojë Sigurimin e Kontratës nëse ekziston.

12.6. Të Drejtat e Palëve Financuese dhe zëvendësimi i koncesionarit:

12:6.1. Njoftimi i Palëve Financuese:

Menjëherë pas marrjes dijeni për shkelje serioze nga ana e koncesionarit të detyrimeve kontraktore, që çenojnë zbatimin dhe operimin e koncesionit ose sjellin si pasojë zgjidhjen e kontratës sipas pikave 12.1.2, 12.1.3, 12.1.4, 12.1.5 e 12.1.6 të nenit 12 të kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktues përveç njoftimit të koncesionarit sipas pikës 12.4 të këtij neni, njofton edhe Palën Financuese me qëllim dhënien e një mundësie, kësaj të fundit, për të ndihmuar

Faqe 14 nga 23

koncesionarin për të korrigjuar ose marrë masa për të rregulluar këto shkelje brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e një njoftimi të tillë. Autoriteti Kontraktues i jep Palës Financuese ndihmesë të arsyeshme për këtë qëllim.

12.6.2. Zëvendësimi i Koncesionarit

Në rast se nuk është bërë i mundur korrigjimi i shkeljes nga koncesionari, Pala Financuese (nëse e gjykon me interes) zgjedh, të ndërhyjë duke i propozuar Autoritetit Kontraktues, transferimin e Projektit në duart e një ekipi menaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues i cili duhet që të ketë, ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjëndjen financiare të paktën të barazvlershme me atë të Koncesionarit;

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues nuk do të pengojë apo vonojë pa arsye, pëlqimin e tij dhe do të bëjë ato veprime që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim të drejtash në lidhje me Palët Kontraktuese.

Zëvendësuesi, do të ketë të drejtën e menaxhimit/administrimit të projektit dhe do të realizojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e koncesionarit, por nuk do të ketë të drejtë të shesë, të transferojë, të vendosë barra siguruese mbi hidrocentralet.

12.6.3. Nëse Pala Financuese vendos të mos ushtrojë të drejtat e parashikuara në këtë nen, ose nëse edhe pas ushtrimit të këtyre të drejtave nuk arrihet në një zgjidhje të arsyeshme për vashdimësinë e projektit, kontrata do të zgjidhet.

12.7. Pagesat në rast zgjidhjeje të Kontratës:

12.7.1. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga Autoriteti Kontraktues për faj të koncesionarit.

Ne rast te zgjidhjes se Kontrates per faj te Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues nuk merr persiper asnje detyrim per pagesa ndaj Koncesionarit.

12.7.2. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga Koncesionari për faj të Autoritetit Kontraktues.

Në rast të zgjidhjes së kontratës për faj të Autoritetit Kontraktues, ky i fundit duhet t'i paguajë koncesionarit, vlerën e investimit të kryer deri në momentin e zgjidhjes së kontratës, si dhe fitimin e munguar, që Koncesionari mund të nxirrte deri në përfundim të afatit të kësaj kontrate (35 vjet), siç llogaritet në paragrafin më poshtë:

Fitimi i munguar = $(35 - \text{Numrin e viteve deri në datën e Zgjidhjes}) \times 0,6 \times (\text{Kthimi Mesatar mbi Kapitalin për periudhën prej 3 vitesh të njëpasnjëshëm që i paraprin Zgjidhjes}) \times (\text{vlera mesatare e Kapitalit të Vet për periudhën prej 3 vitesh të njëpasnjëshëm që i paraprin Zgjidhjes})$.

12.7.3. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga secila palë

Në rast zgjidhjeje të kontratës nga secila palë, sipas pikës 12.3.1 të këtij neni, Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim për pagesa ndaj koncesionarit.

Neni 13 Kontratat

13.1. Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për zbatimin e punimeve të projektit dhe çdo lloj kontratë tjetër, me qëllim realizimin e objektit të koncesionit, duke respektuar kufizimin e vendosur në nenin 17.2 të kësaj kontrate. Në të gjitha kontratat, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate koncesioni.

Koncesionari duhet të pajisë Autoritetin Kontraktues me informacionin e mëposhtëm për nënkontraktuesin e propozuar:

- i. Emrin e tij dhe adresën;
- ii. Qëllimet për të cilat nënkontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga nënkontraktuesi i propozuar; dhe
- iii. Vlerën e nënkontratës
- iv. Çdo informacion i mëtejshëm i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.

13.2. Koncesionari është përgjegjës përpara Autoritetit Kontraktues individualisht dhe solidarisht me nënkontraktuesin, për përmbushjen e detyrimeve nga ana e nënkontraktuesit.

13.3. Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionarit.

Neni 14 Sigurimi i kontratës

14.1. Koncesionari, para nënshkrimit të kontratës, duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, një shumë prej 214,941,147 (dyqindekatërmbedhjetemilion nenteqindedyzetënjemije njeqindedyzeteshtate), që përbën 10 % të vlerës totale të investimit. Formulari i sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkëlidhet kësaj kontrate.

14.2. Koncesionarit i lejohet të ç'ngurtësojë këtë vlerë, bazuar në parashikimet e nenit 11, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga kryerja e testimit të veprës dhe vënia në punë.

14.3. Sigurimi i Kontrates do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar, të detyrimeve të Koncesionarit në lidhje me perfundimin e punimeve të ndërtimit dhe perfundimin e testimit.

Neni 15 Sigurimet

15.1 Koncesionari në çdo kohë do të pajiset, mbaje dhe ripërterije ato garanci sigurimi të kerkuara në lidhje me ushtrimin e të Drejtave Koncesionare dhe përdorimin e Objekteve Ekzistuese (në

Faqe 16 nga 23

se ka), dhe do t'i percjelle, ose do te kujdeset qe t'i percillen Autoritetit Kontraktues kopjet e certifikuara te çdo çertifikate sigurimi pas marrjes se nje njoftimi te arsyeshem paraprak prej Autoritetit Kontraktues.

- 15.2 Koncesionari duhet të siguroje punimet e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të paktën nga rreziqet e parashikuara nga klasat e sigurimit 8 e 9 të nenit 7 të Ligjit 9267 dt.29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" gjatë gjithë periudhës së Koncesionit dhe do të dorëzoje pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit, brenda një afati 15 ditor nga data e sigurimit.
- 15.3 Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit, apo gjatë operimit të objektit vlera e dëmit e kompensuar nga siguruesi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të perdoret për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen që ishte para dëmtimit. Pjesa e zbritshme nga shuma qe siguruesi do te paguaje per kompesimin e demit do te perballohet nga koncesionari.
- 15.4 Koncesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.
- 15.5 Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjësie jo më të ulët se 200 000 Euro për çdo ngjarje dhe 500 000 Euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1000 Euro për çdo ngjarje dhe 2000 Euro në vit.
- 15.6 Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 16

Tarifa koncesionare dhe vlera e riinvestimit

16.1 Tarifa koncesionare

Koncesionari duhet të paguaje për llogari të Autoritetit Kontraktues një tarife koncesionare të barabartë me vlerën e 4 % të prodhimit vjetor të energjisë elektrike, si dhe të çdo përfitimi tjetër që Koncesionari do të ketë, në raport të drejtë me përqindjen që përfaqëson tarifën koncesionare, nga prodhimi i kësaj energjie elektrike, duke përfshirë por pa u limituar në të drejtat që rrjedhin nga reduktimi i karbonit dhe gazrave të tjerë në atmosferë.

Kjo tarifë nuk do të jetë objekt ndryshimesh deri në përfundim të kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit.

16.2 Vlera e riinvestimit

Duke filluar nga viti i 25-të nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, Koncesionari do të riinvestojë 60 % të vlerës së investimit për makineri dhe pajisje, sipas një grafiku që do të hartohet nga palët për këtë qëllim.. Kjo vlerë do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

Faqe 17 nga 23

Neni 17 Kufizimet

- 17.1 Për çdo transferim të aksioneve/të kapitalit themeltar të saj tek të tretët Koncesionari ose shoqëria e re koncesionare duhet të marrë pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktues.
- 17.2 Shoqëria e re që do të krijohet, sipas nenit 8.1, dhe/ose Koncesionari ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet që do të krijohen në zbatim të projektit të punimeve si dhe të lidhë çdo lloj marrëveshje financimi me çdo Palë Financuese, me kusht që hipoteka, pengu apo barra tjetër si dhe marrëveshja përkatëse e financimit t'i shërbejë përmbushjes së detyrimeve të Koncesionarit në këtë Kontrate.

Neni 18 Raportimi

- 18.1. Koncesionari është i detyruar që çdo tre (3) muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 19 Legjislacioni i zbatueshem

- 19.1. Lidhja, zbatimi dhe interpretimi i kësaj Kontrate Koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar.

Neni 20 Forca Madhore

- 20.1. Konsiderohen Ngjarje të Forcës Madhore:
- i. Katastrofat e natyres, përmytjet, tërmetet, ndotje nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me to;
 - ii. Lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, bllokada, embargo- që zgjasin për një kohë jo më të vogël se një muaj;
- 20.2. Në rastet e Forcës Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 30 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e përmbushjes së detyrimeve në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën.
- Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore. Kufijtë e përmbushjes së detyrimeve, do të përcaktohen nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre.
- Periudha e koncesionit do të zgjatet në përputhje me nenin 4.2.2 të kësaj kontrate.

20.3. Zgjidhja e kontratës për shkak të forcës madhore

Pala e prekur nga forca madhore ka te drejte te zgjidhe kontraten e koncesionit :

- i. në rast se edhe pas zbatimit të pikës 20.2 të këtij neni, nuk është arritur një zgjidhje në të mirë të projektit,
- ii. kur forca madhore zgjat më tepër se 6 muaj.

20.4. Pasojat e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore

Në rastet e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore, palët nuk kanë detyrime ndaj njera tjetrës dhe secila palë do të perballojë kostot e veta.

20.5. Zgjidhja e mosmarrëveshje që vijnë si pasojë e forcës madhore do të bëhet në përputhje me nenin 22 të kësaj kontrate.

Neni 21

Hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit

21.1. Kontrata e Koncesionit do të hyjë në fuqi pasi të nënshkruhet nga palët, në përputhje me Ligjin Nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, i ndryshuar.

Neni 22

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

22.1. Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.

22.2. Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Koncesioni, do të jetë Gjykata e Arbitrazhit, që do të krijohet dhe funksionojë sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë. Gjykimi do të bëhet nga një grup prej 3 arbitrash, nga ku secila palë zgjedh një arbiter dhe këta dy arbitra zgjedhin arbitrin e tretë.

22.3. Fillimi apo vazhdimi i negociatave për zgjidhje me dialog, apo i procedurave gjyqësore të arbitrazhit nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj Kontrate.

22.4. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve nëpërmjet procedurës së arbitrazhit do të jetë e zbatueshme vetëm në rast se nuk bie ndesh me ndonjë rrethane, fakt apo ngjarje që e ben të pamundur ekzekutimin e këtyre procedurave. Në këtë rast, mosmarrëveshja do të jetë objekt gjykimi nga gjykata e shkallës së parë Tiranë.

Neni 23 Sanksionet

23.1. Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate, në përfundim të periudhës të parashikuar në nenin 10 të kësaj kontrate, penalizon Koncesionarin si më poshtë:

- i. Për shkelje të afatit të ndërtimit 0,05 % në ditë të vlerës së investimeve të munguara.
- ii. Për moskryerje në total të investimeve për vlerën e të cilës është rënë dakord sipas nenit 9.3, Koncesionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të përealizuara.
- iii. Për çdo ditë vonesë për fillimin e punimeve penalizohet me 10 000 lekë.

Këto penalitete do të mbahen nga Sigurimi i Kontrates parashikuar në nenin 14 më sipër, duke patur parasysh se nëse vlera e këtij sigurimi nuk është mjaftueshme për shlyerjen e penaliteteteve, Koncesionari do t'ua plotesoje këtë shumë, rast pas rasti.

23.2. Mosrealizimi i prodhimit të energjisë elektrike dhe fuqisë së vendosur sipas kushteve të rëna dakord me këtë kontratë, penalizon Koncesionarin si më poshtë:

- i. Në rast mosrealizimi, për faj të Koncesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 101,500,000 KWh/vit, Koncesionari penalizohet me tarifen koncesionare prej 4% të vlerës së prodhimit të përealizuar për periudhën raportuese. Në rast kur prodhimi nuk realizohet për shkak të tjerave (jo për faj të koncesionarit), Koncesionari nuk penalizohet për prodhimin e munguar; ndërkohë, Koncesionari është i detyruar të paguajë tarifen koncesionare, në vlerën prej 4 % të prodhimit të realizuar.
- ii. Për mosrealizim deri në 10 % të fuqisë së vendosur, përcaktuar sipas nenit 3 të kësaj kontrate, Koncesionari penalizohet në shumën e llogaritur si më poshtë:

Shuma e penaltetit = Prodhimi vjetor i energjisë elektrike x Fuqia e pënstaluar (në %) x Vitet e operimit si të llogaritura në oferte x Çmimi i shitjes së energjisë elektrike vendosur nga ERE në momentin e kryerjes së testimit të veprës sipas nenit 11 të kësaj kontrate x Fee Koncesionare (në %).

Ky penaltet do të aplikohet në momentin e testimit të veprës në përputhje me nenin 11 të kësaj kontrate.

23.3. Palët bien dakord që sanksionet e parashikuara në paragrafet 23.2 do të zbatohen deri në një vlerë prej 10 % të vlerës së investimit. Sanksionet do të llogariten çdo fund viti kalendarik, sipas një akti rakordimi të përbashkët që bëhet ndërmjet palëve të kësaj Kontrate.

- 23.4. Sanksionet paguhen në llogari të Autoritetit Kontraktues. Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të diskutojnë për një periudhë 30 ditore lidhur me shkeljen.
- 23.5. Kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 20 ditësh. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.

Neni 24 **Rregullimi i shkeljeve**

- 24.1. Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë periudhës së koncesionit, Koncesionari ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të permendura në këtë kontratë, ai menjehere ia bën të njohura këto shkelje Koncesionarit duke pritur për një periudhë 40 ditore përgjigjen e tij, me argumentat përkatëse. Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.
- 24.2. Kjo procedurë nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mospermbushja e detyrimeve.

Neni 25 **Transferimi i Aseteve**

- 25.1. Me mbarimin e kontratës, Koncesionari do të kryejë çdo veprim të nevojshëm për dorëzimin tek Autoriteti Kontraktues, të aseteve të marra në dorëzim nga ai, ato të realizuara nga Koncesionari gjatë periudhës së koncesionit si dhe çdo titull mbi to, të zhveshura nga çdo lloj detyrimi, barre apo hipoteke.
Proçesi i Dorëzimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Koncesionit me një inspektim të përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.
- 25.2. Koncesionari, duhet të transferojë pa kundërshtim në favor të Autoritetit Kontraktues:
- i. hidrocentralin dhe objektet ekzistuese të lidhura me të;
 - ii. ndërtesa, makineri, pajisje;
 - iii. pronësinë mbi ndërtesat apo impiantet e ndërtuara nga ai;
 - iv. të drejtat kontraktore ;
 - v. dorëzimin e librave, dokumentave dhe garancive që shoqërojnë këto asete;
 - vi. çdo të drejtë tjetër të fituar nga ai nëpërmjet kësaj kontrate;
- 25.3. Koncesionari, duhet të provojë se këto asete janë të mirëmbajtura dhe në gjendje të mirë pune, duke marrë parasysh normën e amortizimit përkatës.
Në rast se kontrata është zgjidhur për shkak të forcës madhore, koncesionari duhet të provojë se gjendja ekzistuese e aseteve ka ardhur si pasojë direkte e saj.

- 25.1. Çdo e drejtë që koncesionari ka fituar me këtë kontratë, do të mbarojë me transferimin e projektit.
- 25.2. Kostot e transferimit të projektit do të përballohen nga koncesionari, përveç rastit kur zgjidhja e kontratës ka ardhur për faj të Autoritetit Kontraktues.

Neni 26 **Mbarimi i kontratës**

- 26.1. Kontrata koncesionare mbaron me përfundimin e afatit 35 vjeçar, duke patur parasysh parashikimet e nenit 4 të kësaj kontrate.
- 26.2. Mbarimi i kontratës si përfundim i afatit të saj ose në rast të zgjidhjes së parakohshme, nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.

Neni 27 **Konfidencialiteti**

- 27.1. Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

Neni 28 **Ndryshime**

- 28.1. Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe/ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve.
- 28.2. Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.



Neni 29 **Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit**

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet palëve, do të bëhet vetëm me shkrim, në adresat e treguara më poshtë nga palët. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të secilës prej këtyre të dhënave, brenda një afati 10 (dhjetë) ditor nga data e ndryshimit.

Për çdo ndihmë që do t'i kërkohej Autoritetit Kontraktues nga koncesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate. Adresat dhe numrat e kontaktit që do të perdoren gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje janë:

Për Autoritetin Kontraktues

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë
dhe Energjetikës
Blvd. Zogu i Pare, Nr. 1001,
Tiranë - Shqipëri

Për Koncesionarin

Shoqëria "Roen Company" sh.p.k.
Adresa: Blvd. Zogu i Pare, Pallati pranë
Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Kati II,
Zyra 2 - Tirane
Tel: +35542264675
Email:

Neni 30
Rregjistrimi i Kontratës

Brenda 30 ditëve nga miratimi i projektit të zbatimit, kjo Kontratë duhet të rregjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Kjo kontratë u hartua në 3 (tri) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë
dhe Energjetikës

Përfaqësuar nga :

z. Genç RUL

KONCESIONARI

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive
"Roen Company" sh.p.k, "Shansi Invest"
sh.p.k, "Archimed International" sh.p.k,
"Sigers" sh.p.k dhe "Sina - 98" sh.p.k,

Përfaqësuar nga :

z. Brunila JEGENI